

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Lista Serbe kërkon forcimin e misioneve të KFOR-it dhe EULEX-it para vendimit të Hagës
ADRESA	https://albeu.com/kosove/lista-serbe-kerkon-forcimin-e-misioneve-te-kfor-it-dhe-eulex-it-para-vendimit-te-hages/1011019/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 14:17:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 14:13:42 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	adbb4fbaec7915b3af3eac6a97e792a1e49298b3200aa061a2effd313e07316d
TEKSTI	b35717fa752e3443b2b374e3bcb4b89e9716020ba0dd0633b3702799a00cecaa
PAMJA	9b4ad312ea3ed2c980e7325c1127f552c5d0bddc97aa6ad75923419f56ca0e23

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	64a35149b31ee9dbbc805cc3782b758836cdd09edd82c7d886da08a8aa585ad5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6e410cf6c3be6bd40f75161c1288a8066fcd1b6e7ab80a3c789507dd842f2954
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/64a35149b31ee9dbbc805cc3782b758836cdd09edd82c7d886da08a8aa585ad5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Lista Serbe kërkon forcimin e misioneve të KFOR-it dhe EULEX-it para vendimit të Hagës



Lista Serbe i ka kërkuar KFOR-it dhe EULEX-it të marrin masa të menjëhershme për ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë, sidomos në periudhën që i paraprin shpalljes së aktgjykimit ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Sipas komunikatës së partisë, misionet ndërkombëtare duhet të veprojnë brenda mandatit të tyre dhe të garantojnë sigurinë në territorin e Kosovës dhe Metohisë gjatë ditëve kur pritet vendimi për të akuzuarit në Hagë.

Partia politike serbe vlerëson se prania e misioneve ndërkombëtare të sigurisë duhet të rritet në zonat e përziera, veçanërisht në vendbanimet serbe në jug të Ibrit.

Lista Serbe thekson se një prani më e madhe do të shërbente si masë parandaluese kundër çdo përpjekjeje për të cenuar sigurinë e qytetarëve, për të nxitur incidente apo për të prishur rendin dhe qetësinë publike.

Gjithashtu, nga KFOR-i dhe EULEX-i kërkohet që, në kuadër të kompetencave të tyre, t'i bëjnë thirrje Policisë së Kosovës që detyrat t'i ushtrojë në mënyrë profesionale, të përgjegjshme dhe të paanshme.

Sipas partisë, Policia e Kosovës duhet të veprojë vetëm në përputhje me ligjin, duke respektuar të drejtat dhe sigurinë e çdo qytetari, pavarësisht përkatësisë së tij kombëtare.

Lista Serbe e ka vënë theksin te nevoja për masa të shtuara parandaluese përpara 16 shtatorit, datë kur është paralajmëruar shpallja e aktgjykimit në Hagë.

Qëllimi i këtyre masave, sipas njoftimit, është shmangia e tensioneve, provokimeve dhe incidenteve të mundshme që mund të cenojnë paqen dhe stabilitetin në terren.

Partia u ka bërë thirrje serbëve dhe të gjithë qytetarëve që të ruajnë qetësinë, të tregohen të përmbajtur e të matur dhe të mos ndikohen nga provokimet eventuale.

të fundit /



Në 29-vjetorin e lindjes, Egli Tako poston foton e veçantë: Sot janë t...



Lista Serbe kërkon forcimin e misioneve të KFOR-it dhe EULEX-...



Florent Muslija mohon bojkotin: Të luaj për Kosovën është krena...



Reuters: Aktgjykimi ndaj Thaçit në Hagë, një ngjarje tektonike ...



Haga pret vendimin për ish-krerët e UÇK-së, në seancë zyrtarë,...



Nuanca e kumbullës pritet të dominojë modën e vjeshtës dh...



SHBA i dërgon paralajmërim Serbisë për afrimin me Kinën ...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Lista Serbe ka vlerësuar se sjellja e përgjegjshme e qytetarëve mund të ndihmojë në ruajtjen e paqes dhe sigurisë.

Në përfundim, partia ka shprehur pritshmërinë që misionet ndërkombëtare të veprojnë në kohë dhe me përgjegjësi, duke dëshmuar gatishmërinë për të përmbushur mandatin e tyre dhe për të garantuar sigurinë e të gjithë qytetarëve, veçanërisht në zonat e ndjeshme dhe të përziera.

Shtuar më 14.09.2026 16:13

Tags: lista serbe , tmerre



Reuters: Aktgjykimi ndaj
Thaçit në Hagë, një ngjarje
tektonike për Kosovën dh...



Haga pret vendimin për ish-
krerët e UÇK-së, në seancë
zyrtarë, familjarë e...



IPK kërkon pezullimin e
policit të dyshuar për
përvetësimin e 105 eurov...



Rutte: KFOR-i do të
qëndrojë në Kosovë
pavarësisht zhvillimeve t...



Kontrolle të shtuara në
dyqanet e tekstitil për
çmimet, promocionet dhe...



Policia e Kosovës rrit
gatishmërinë për 16
shtatorin, mund të ketë...



Transporti ajror në Kosovë
rritet, ndërsa ai hekurudhor
shënon rënie



Salihaj: Moszgjedhja e
presidentit mund ta rikthejë
Kosovën në zgjedhje të reja



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.